

## **NË EMER TE POPULLIT**

**Gjykata Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Rënda**, duke vendosur sipas kryetarit te trupit gjykues Naser Maliqi, me sekretaren juridike Zahide Rexhepi, ne ceshtjen penale të akuzuarit F. G., për shkak të vepres penale, kultivimi I bimes se hashashit, shkurses se kokaines ose bimeve te kanabisit nga neni 278 paragrafi 1 te KPRK-se, të cilin e mbron av. V. I. me autorizim, e sipas aktakuzes se Prokurorise Themelore në Gjilan , Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr 215/ 16, e dt. 08.09.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me dt.19. 09. 2016, shpalle:

## **AKTGJYKIM**

**Ndaj te pandehurit F. G.**, nga babai V. dhe nena Q., e lindur B., i lindur me date ... ne fshatin V., tani me banim ne Gj., lagja “ ...”, rr.”...”, nr. ... , ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje të varfër ekonomike, I pa martuar, shqiptar , shtetas I Republikës së Kosovës.

## **ËSHTE FAJTORE**

Sepse ne shtepine e tij ne Lagjen “...”, rr, ..., nr. ..., ka kultivuar ne menyre te pa autorizuar bimen- kanabis sativa per prodhimin e sunstances narkotike Marihuane, e qe me dt .... 2016, gjate kontrollit dhe bastisjes nga Njesiti DHTN ne Gjilan, eshte gjetur ne lokalet e shtepise se tij dhe ate: ne katin e dyte ne dhomen e te pandehurit , perkatesishte ne dollapin e rrobave jane gjetur tri bime narkotike kanabis sativa te mbjellur ne vazo te plastikes, dhe qe prane ketyre bimeve kane qene te vendosura poqat elektrik dhe pasjisjet tjera e vendosura per zhvillimin e tyre, ndersa po ashtu jane gjetur edhe dy kavanoza te qelqit me substance narkotike te llojit Marihuane me peshe prej 70.8,gr, te cilat I pandehuri me te vrejtur ardhjen e policies I kishte hedhur nga tarasa e shtepise se tij ne oborrin e fqiut te tij, te cilat si bimet tjera dhe pajisjet per zhvillimin e ketyre bimeve I jane konfiskuar perkohsishte me daten dritike nga Njesit Antidroge I Poicise se Kosoves.

-me c’raste ka kryer vepren penale kultivimi I bimes se hashashit, shkurses se kokaines ose bimeve te kanabisit nga neni 278 paragrafi 1 te KPRK-se

-Andaj, ne baze te nenit 4, 41,42,49, 50,51, 69, 73,74, 75, 76 dhe 91 të KPRK-së , si dhe nenit 365 dhe 451 te KPPRK-se.

## **E GJYKON**

**Me denim burgu në kohëzgjatje prej 180 ditësh, I cili denim nuk do të ekzekutohet,** me kusht që në afat prej dy viteve I akuzuari të mos kryej veprë tjetër penale.

**Te pandehurit F. G.** I urdhërohet masa e trajtimit me rehabilitim të detyrueshëm në institucionin e kujdesit shëndetsor për personat e varur nga droga ose alkooli, **ne liri në kohëzgjatje prej një viti.**

**Detyrohet i pandehuri F. G.,** që kësaj gjykate t'ia paguaj shumën prej 20 euro, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogaritës së fundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- **Konfiskohen** bimët kultivuar të llojit Kanabissativa, të substancës narkotike Marihuansi dhe pajisjet që janë përdorur për kultivimin e tyre të përshkruara sipas vendimit për konfiskimin e perkohshme të policisë.

## **ARSYETIM**

**Prokuroria Themelore në Gjiçan, Departamenti për Krime të Rënda,** me dt. 09.09.2016, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.215/ 16, ndaj të akuzuarit F. G., për shkak të veprës penale, kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimeve të kanabisit nga neni 278 paragrafi 1 të KPRK dhe ka kërkuar që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet me denim meritor sipas ligjit.

Gjykata, me dt 16.09.2016 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën i pandehuri F. G., e ka pranuar në tërësi veprën penale e cila i vihet në barë si në aktakuzë, e ndien vetën fajtor dhe ka kërkuar falje.

Gjykata e ka aprovuar këtë praninë të fajësive, pas marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit dhe nga mbrojtësi i të akuzuarit dhe nga vetë i akuzuari.

Gjykata e ka aprovuar praninë e fajësive, për shkak se ky praninë është bërë në mënyrë vullnetare, pa imponim dhe pa asnjë presion, duke i ditur pasojat e pranimit të fajësive, sepse ky praninë i fajësive është në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës siq janë : proces verbal mbi bastisjen e banesës dhe personave, foto albumi nga vendi i ngjarjes.

Gjatë matjes dhe shqyrtimit të denimeve, Gjykata ka patur parasysh sjelljen e mirë të të akuzuarit në Gjykate, praninë e fajësive nga ana e të pandehurit pa

asnjë hezitim, pendimin e tij për veprën e kryer, ka kërkuar falje dhe i ka premtuar gjykates se nuk do ta perseris veprën si dhe gjedjen e tijë matriale shumë të rendë, është I pa punë, është duke u trajtuar që nga viti 2005 e tutje, për shkak të problemeve nga përdorimi I substancave psikoaktive , drogave, heroines dhe marihuanes), këtu e dëshmon edhe vërtetimi I leshuar nga Qendra e Shëndetit Mendor në Gjilan e dt. ... .2016.

Të njëjtit krahas denimit me kusht, gjykata I ka shqiptuar edhe masën e trajtimit me rehabilitim të detyrueshëm në institucionin e kujdesit shëndetsor për personat e varur nga droga ose alkooli, **ne liri ne kohezgjatje prej nji viti.**

Për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ku i akuzuari është shpallur fajtor dhe gjykuar për veprën penale si në dispozitiv me denim burgu në kohezgjatje prej 180 ditëve, me kusht që në afat prej dy viteve të mos të kryej veprë tjetër penale, si dhe masën e lartepërmendur, me bindje se edhe ky lloj I denimi si dhe masa e trajtimit të detyrës për personat e varur nga narkotik ose nga alkooli, do të ndikojnë të I pandehuri që në të ardhmen të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

**Gjykata I ka konfiskuar bimët kultivuese të llojit “ Marihuane” si dhe pajisjet që janë përdorur për rritjen dhe kultivimin e tyre .**

Gjykata të pandehurin e ka detyruar, që kësaj Gjykate t’ia paguaj shumën paushalle prej 20 euro, ndërsa shpenzimet e procedurës sipas llogaritës përfundimtare të kësaj Gjykate.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RENDA**

**Me dt 19.09.2016**

**Sek. Jurdike,  
Zahide Rexhepi**

**Kryetari I trupit:  
Naser Maliqi**

**KSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi, palet e paknaqura mund të ushtrojnë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.